ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal MAPL**
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **212-23-2115-5-1-1**
(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për: ” Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në komunën e Fushë Kosovës në lagjen 28, 29, Bardh i Madh dhe Sllatin e Madhe”

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Konsorciumi: K-ING sh.p.k, URBAN O.P & "HIDRO PROJECT SH.P.K shpk

Kalabria, Blloku A1, Llamela B KV/18
(Adresa)

Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
049 224005 — *N/A*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Avni Kuçi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
avni.kuci@king-ks.com
(Adresa elektronike)

14.08.2023
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

"K-ing" SH.P.K. PRISHTINË - KOSOVË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Noftimi për kontrat, datë 23.03.2023 mbi aktivitetin e prokurimit
2. Dosja e tenderit, B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, datë: 26.04.2023, 11.05.2023, 15.05.2023, 23.05.2023
3. Kërkesat për rishqyrtim të publikuara në e-platëform KRPP, datë: 15.05.2023, 23.05.2023
4. Procesverbali i hapjes 06.06.2023
5. Dosja e tenderit e permisuar finale e datës: 23.05.2023
6. Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, datës: 25.07.2023
7. Kërkesa për rishqyrtim 31.07.2023
8. Vendimi i Kerkeses për Rishqyrtim 02.08.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐				**Jo**	☐	

Përmes platformës se E-prokurimit kemi pranuar procesverbalin e hapjes së tendërve.
Procesverbali hapjes së tenderave me datë 06.06.2023
Proceseverbali hapjes është bërë më një ditë vonesë jo sipas dosjes së tenderit qe ka qen me datë 05.06.2023 ora 14:00.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☐				**Jo**	☐	

Në bazë të vendimit datë 25.07.2023 (e bashkangjitur)

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 – Qëllimi
- Neni 7- Barazia në trajtim/Jo-Diskriminimi dhe transparenca
- Neni 13 - Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik
- Neni 56.3 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59- Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tënderëve
- Neni 69- Aftësia teknike dhe ose/ profesionale
- Neni 72 – Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë
- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 01/2023

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në bazë të ligjeve të Prokurimit në fuqi, nga data e publikimit lidhur me Njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, MAPL, tutje identifikohet AK, datës: 25.07.2023, ne si Grup i operatorve ekonomik në bazë të afatave ligjore kemi parqitur Kërkesen për rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues, me datë 31.07.2023 kemi marrë "Përgjigjeje në kërkesën për rishqyrtim "K-ING" , dokumenti datë 02.08.2023 Ku në këtë rast AK nuk ka shpjeguar në detal kërkesat tona të pretenduara, bashkangjitur në këtë ankes, përgjigjet e AK.

Pretendimi nr 1:

Si shkelje procedural në lidhje gjatë fazes së këtij aktiviteti të Prokurimit, procesi hapjeve të tenderit, Afati i fundit për dorëzim të ofertave sipas dosjes të tënderit (DT) ka qenë me datë 05.06.2023, ora 14:00:00 dhe hapja ofertave me datë 05.06.2023 ora 14:00.

Ndërsa hapja ofertave është dërgua me datë 06.06.2023, pas kërkeses tonë me email, ne nuk jemi njoftu për problemet që ka dhënë AK në vendimin kërkesen për rishqyrtim edhe pse dokumentacioni I bashkangjitur nuk shihen detalet e emailit drejtuar KRPP.

Kërkesa në dosje të tenderit në lidhje me afatin e fundit të dorëzimit të tenderave dhe hapja e tenderave.

Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	Afati i fundit për dorëzim është je **05.06.2023 14:00:00**

	Vendi: **Në platformën elektronike https e-prokurimi.rks-gov.net**
Hapja e Tenderit	Hapja e tenderit do te bëhet me **05.06.2023 14:00:00** Vendi: **Ndërtesa e Ish Rilindjes kati 12 përmes platformës elektronike https e-prokurimi.rks-gov.net**

Pretendimi 2:

U sqaru se afati I fundit për dorëzim të ofertave sipas kërkeses së DT, me datë 05.06.2023, ndërsa ne kemi marrë Njoftiin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me datë 25.07.2023, një shkelje procedural pa na njoftuar për nevojat rrethë zgjatjes së afatit në lidhje me vendimin e AK.

Pretendimi 3:

Deklarat mbi fakte dhe argumente:

Me datën 27.07.2023, ora 15:31, në platformën E-prokurimit, kemi pranuar formularin B58, Njoftim për vendimin e AK, me të cilin nuk pajtohemi fillimisht me arsyet e eliminimit tonë dhe poshtu me rekomandimin e një operatori ekonomik i cili është i papërgjegjshem.

Në vijim i paraqesim faktet dhe argumentet tona lidhur me arsyet e eliminimit.

Në letren standarte të tenderuesit të eliminuar si arsye të eliminimit AK ka permendur një reference e cila sipas AK nuk eshte leshuar Brenda periudhes së kërkuar në dosje të tenderit dhe rrjedhimisht sipas AK, nuk e plotesojmë kërkesen per 60% te vleres se kontratave si lider.

Bazuar në dispozitat ligjore që përcaktohen në nenin 59 të LPP-së, vleresimin e ofertave duhet ta beni në perputhje me nenin si autoritet kontraktues, vleresimin e ofertave duhet ta bëni në perputhje me paragrafin 4 të nenit 59 te LPP-së, sepse në këtë paragraf thuhet: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Kërkesa në dosje të tenderit:

9.1.9 **Kapaciteti teknik dhe professional:**

Kërkesa 9. - Kontrata të natyrës së punëve të ndërtimit të ujësjellësve, të përfunduara me Sukses gjatë 3 (tre) vitet e fundit, **deri në datën e publikimit të këtij Njoftimi të Kontratës.**

Vlerësimi I AK-së se nuk e plotesojmë kërkesen është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 56 të LPP-së, sepse na keni eliminuar për një kërkese e cila nuk ekziston në dosje të tenderit. Nga arsyetimi I KONTRATE, por kjo kerkese nuk ekziston në dosje të tenderit as ne njoftimet për korigjim/përmiresim të gabimeve të publikuara në platformen e E-Prokurimit.

Kerkesa e AK ka qenë shumë e qartë, sepse është kërkuar kontrata dhe referenca në tri vitet e fundit **DERI NE PUBLIKIMIN E NJOFTIMIT TE KONTRATES,** që do të thotë deri me daten: 24.03.2023 dhe pranimi teknik sipas pretendimeve të AK se nuk përmbush kërkesen është e leshuar me muajin

shkurt, është dashur të merret parasysh sepse është Brenda kërkeses së përcaktuar në dosje të tendrit dhe po e përserisim se kjo arsye e dhënë nga ana juaj është ne kundershtim me nenin 56.3 te LPP-së

Pretendimi 4:

Sa i perket arsye së eliminimit qe ka te bëjë me 1 (një) makinë për shpuarjen nëntokësore horizontale me system laserik të kontrollit deri në diametrin 500 mm., ku ju deklaroni se KENI OFRUAR MAKINEN PER SHPIM HORIZONTAL ME PJESE PERCJELLESE MARKA DITH ITCH JET TRACK TIP: 2720, E CILA NUK ESHTE NE PERPUTHJE ME KERESEN E AK-së.

Kjo arsye nuk qendron se me një kërkim të thjeshte në internet mund ta verifikoni se pajisja në fjale është në përputhje të plot me kërkesen e dosjes së tenderit.

Konsiderojmë në këtë rast keni shkelur nenin 59 dhe 72 të LPP-së, sepse është dashur ta verifikojnë si AK, paraprakishtë para se të vendoset se a i plotëson specifikat teknike pasija në fjal apo jo.

Nese nuk eka pasur të qartë dokumentacionin e prezentuar, ju kishim ofru informata shtes, tek kjo maqineri me rëndësi të veqant janë aksesorët se me cfar diametri do të realizohet shpimi, i bie që dimatri i shpimit caktohet në bazë të aksesorve shtes. Meqë në dosje të tenderit ka qenë tek kërkesa 5, teknike profesionale, AK të verifikoj në teren paisjet e ofruara, ne ju ftojmë që për makinerin e njëjt ta realizojm një shpim me diameter 500 mm, dhe ta heqni këtë dilem që nuk e kanë vërtetuar drejt.

Pretendimi 5:

Në vazhdim po i japim faktet dhe argumentet në lidhje me OE i rekomanduar për kontratë, i cili nuk plotëson kërkesat dosjës së tenderit ku AK ka kërkuar:

9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa nr 2:

Kërkesa 2. Një Udhëheqës i Punimeve	Evidenca 2. -Një kopje të noterizuar të diplomës diplomës (jo më e vjetër se 1 muaj), dhe një deklaratë të përgatitur dhe nënshkruar nga inxhinieri-udhëheqësi i punimeve, përmes së cilës inxhinieri deklarohet se do jetë i angazhuar në këtë projekt-kontratë; -Një kopje të CV-së e nënshkruara nga vet ing.; -Një kopje të kontratës ose para kontratës valide të punës; dhe -Minimum një referencë si mbikqyres i projekteve te ngjashme -Kontratë/a pune e cila dëshmon përvojën 5 vjeçare.

Kemi sqaruar këtë pretendim tek AK, në kërkesen për ri-shqyrtim, OE i rekomanduar ka propozuar për këtë kërkes inxhinier i diplomuar ndërtimtaris – drejtimi hidroteknik, Z. Mirlind Kabashi, në bazë të qasjes së dokumetancionit dhe shoshitjes së tyre kemi vërejt se referancat janë të përgaditura sa për të përmbush njëren prej kërkesave, e cila ka qenë:

<u>Minimum një referencë si mbikqyrës i projekteve të ngjajshme</u>

OE I rekomanduar për Z. Mirlind Kabashi ka dorëzuar CV-në dhe referencat, mirpo as CV dhe referencat nuk dëshmojn se Z. Kabashi ka realizuar mbikqyrje sipas kërkeses së DT.

Kthehemi tek rregullorja 01/2022 të Prokurimit Publik dhe udhëzuersi 01/2023 Prokurimit Publik, në rastin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE i rekomanduar, për Z. Mirlind Kabashi CV- e dorëzuar nuk përmbush kërkeat – refuzo tenderin.

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

10.1 ***Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së***

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
Lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar Dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Mungon Certifikata e regjistrimit të biznesit	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e TVSH	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon Certifikata e numrit fiskal	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon licenca	Mund të kërkohen informata sqaruese	66
Mungon certifikata ISO	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
Mungon çmimi	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

URE ... Viber A02_Udhezu... UJI - Word F02 Formula... Template pe... Microsoft W... 06. Ing. Hidr...

Se nuk ka relizuar asnje mbikqyrje të projekteve të ngjajshme, na jep me kuptu edhe referenca e lëshuar nga një OE FIDANI-L për Z. Kabashi-në:

FIDANI-L

REFERENCË

Datë : 20.01.2023

Me ketë reference **"FIDANI L" SH.P.K** e regjistruar me Nr Biznesi : **811990177**, tregon se Zt.Mirlind Kabashi i lindur ne Gjakovë me 29.04.1964. është i punësuar ne ndërmarrjen tone si Inxhinier i Hidroteknikes.

Zt.Kabashi Është i angazhuar si Inxhinier ne kompaninë tonë nga data 01.01.2004 me kontratë pune.

Zt.Kabashi prej themelimit te marrëdhënies se punës ne kompaninë si menaxher i disa projekteve dhe udhëheqës i punishteve (mbikëqyrje) për projekte te kontraktuara nga kompania jonë:

AUTORITETI	EMRI I PROJEKTIT	VITI

Nese shohim CV nuk ta të përshkruar asnje projekt për mbikqyrje të projekteve të ngjajshme, në paragrafin e tret të referencës se lëshuar me datë 20.01.2023 thuhet:

Zt. Kabashi prej themelimit te marrëdhënies se punës ne kompaninë si menaxher i disa projekteve dhe udhëheqës i punimeve (mbikqyrje) për projekte te kontraktuara nga kompania jonë:

Pra udhëheqës i punimeve nuk i bjen ekuivalente me mbikqyrje, janë të dy anë të ndryshme, e dëshmon edhe lista e kontratave që asnjera nga titujt në referencë nuk janë mbikqyrje, që rrjedhimisht dhe përfundimisht i bie që Z. Mirlind Kabashi nuk ka asnje kontrat të kompletuar në lidhje me kërkesën në DT të këtij Aktiviteti të prokurimit.

Dhe ku vie absurdi I përgjigjes në vendimin rishqyrtimit nga AK, dates 02.08.2023, në lidhje me këtë pretendim, ne kemi dhënë si shembull se si duket një tituli projektit në raste të mbikqyrjes së projekteve, ndërsa AK jepë përgjigje se ne nuk kemi kërkuar kontrat për mbikqyrje, kontrat e dimë që nuk ka kërkuar, mirpo ka kërkuar që stafi të ketë **Minimum një referencë si mbikqyrës i projekteve të ngjajshme,** sipas kërkesës së DT 9.1 kërkesa 2.

Kemi dhënë këtë shembull:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada -Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije-
Ministry of Trade and Industry

KONTRATA

"Ministria e Tregtisë dhe Industrisë", adresa Rr "Muharrem Fejza" p.n Lagja Spitalit
dhe " K-ING" Sh.P.K. adresa Veternik II p.n , me NRB – 70676494-Prishtine –Avni Kuqi-Drejtor

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS:

" Mbikëqyrja e projektit : Ndërtimi i sistemit për furnizim me ujë Qendra e Panaireve ,Laboratori i Industrisë Kimike dhe Institutin e Produkteve te Ndërtimit "

Numri i Prokurimit: MTI204-12-144 -236

Neni 1 Ligji i zbatueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës,

Nuk kemi pretenduar se AK ka kërkuar në dosje të tenderit kontrat për mbikqyrje të projekteve, e dim dhe ne si OE kemi përmbush këtë kërkese sipas DT kërkesa 2, e OE I rekomanduar për kontrat, respektivisht Z. Kabashi nuk ka asnjë projekt në cilësin e mbikqyrsit, rrjedhimisht I bie qe OE I rekomanduar nuk përmbush këtë kërkes.

Pretendimi 6:

OE i rekomanduar për kontrat nuk plotëson kërkesen e DT në lidhje me planin dinamik, ku AK ka kërkuar:

9.1.6 **Kapaciteti teknik dhe professional:**

Kërkesa 6. **OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar"**	**Dëshmia 6.** **Plani Dinamik - duhet të prezantohet sa më i detajuar i mundshëm (duke i përfshirë të gjitha aktivitetet (pozicionet) që janë të përfshira në paramana.**

Dëshmia 6. Plani Dinamik - duhet të prezentohet sa më i detajuar i mundshëm **(duke i përfshirë të gjitha aktivitetet (pozicionet) që janë të përfshira në paramasa.**

Pasi e kemi pranuar oferten e OE të rekomanduar për kontratë, e kemi analizuar dhe fituesi ka ofruar plan dimanik për VETEM 40 POZICIONE, nga gjithesej 200 pozicione në paramasë, I bie që ka dhënë plan dinamik për 20% të pozicioneve të paramases, pra fituesi nuk e plotëson këtë kërkese sepse në dosje është kërkuar plan dinamik, …**duke u perfshire te gjitha aktivitetet (pozicionet) qe jane te perfshira ne paramase.**

OE i rekomanduar për kontrat nuk ka dhënë plan dinamik sipas kërkeses për pozicionet e paramasës.

Dhe në përgjigjen e pretendimit nr 5 nga AK, në kërkesen për rishqyrtim jep në këtë formë:

> Vlen te theksohet se edhe ju si OE ne planin dinamik te dorëzuar me oferte keni deklaruar se "ne rast te nënshkrimit te kontratës do te dorëzoni planin dinamik te detajuar" prandaj vlerësojmë se pretendimi juaj ne këtë pike nuk qëndron dhe është i pa bazuar.

Në kuptimin logjik I bie qe " qysh e ka bo bërllog OE I rekomanduar e keni bërë edhe ju", edhe pse kemi dhënë deklarat në lidhje palnin dinami dhe në të njëjten kohe kemi dhënë plan dinamik për të gjitha pozicionet sipas kërkeses së DT.

Pretendimi 7:

OE i rekomanduar për kontratë, në oferten e tij e ka dorëzuar pajisjen për shpime horizontale dhe për të njejten ka dorezuar si deshmi një kontrate për qera e cila nuk eshte valide, sepse:

Kontrata eshte e lidhur me mes te Ricommerce construction dhe Infra Plusit, marreveshje e cila eshte NUL, sepse kjo pajisje është marrë me lizing në shtetin e Bullgarisë dhe në vecanti kjo piajisje sipas marreveshjes nuk guxon të nxirret jasht shtetit Bullgar, shih: Follderin nr. 17, makina për shpime horizontale,

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRESIT, FAQE NR 36, ku kufizohen te drejtat e qiramarresit, lidhur me perdorimin e makinerise në fjalë:

> Neni 21. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të:
>
> (1) të përdorë objektin e dhënë me qira në kushte ekstreme /si p.sh. pjesëmarrja në mitingje, për qëllime sportive, si mjet stërvitor, si taksi, etj./ dhe të manipulojë pajisjet e kontrollit dhe matjes së objektit të dhënë me qira. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të ndryshojë vendbanimin/magazinimin e sendit të dhënë me qira, përveçse me pëlqimin e shprehur paraprak me shkrim të QIRAdhënësit;
>
> (2) të shesë, hipotekojë ose të ngarkojë në ndonjë mënyrë tjetër sendin e dhënë me qira për kohëzgjatjen e kësaj kontrate, si dhe të bëjë ndryshime në sendin e dhënë me qira;
>
> (3) kryejnë veprime që do të zvogëlojnë vlerën e sendit të dhënë me qira;
>
> (4) t'u japë administrimin/përdorimin e sendit të dhënë me qira personave të paautorizuar prej tij; (5) t'i japë administrimin/përdorimin e sendit të dhënë me qira një personi të paaftë
>
> shofer me aftësi të kufizuara për llojin përkatës të objektit të qirasë
>
> (6) të lërë objektin e dhënë me qira jashtë kufijve të Republikës së Bullgarisë pa pëlqimin paraprak me shkrim të QIRAdhënësit. Pëlqimi konsiderohet i dhënë me dhënien e prokurës me nënshkrime të noterizuara, teksti i së cilës përfshin të drejtën e përdorimit të sendit jashtë vendit. Qiramarrësi siguron me shpenzimet e tij sendin e dhënë me qira me sigurim ndaj rreziqeve të dëmtimit të

Sipas të drejtave të përcaktuara në këtë nen, operatori ekonomik nuk ka të drejte ta nxjerr jasht territorit te Republikes së Bullgarise, rrjedhimisht OE i rekomanduar per kontrate, vetem sa për të

mbuluar kërkesen e dosjes së tenderit i ka dorëzuar këto dëshmi, e që nuk mund ta perdore asnjeher sepse ne piken 6 te nenit 21 sanksionohet nxjerrja jasht territorit të kësaj pajisje.

Pretendimi 8:

Pretendim tjeter është i rekomanduari për kontrate, ka dorezuar certifikata të sladuesve në gjuhë jo zyrtare, pra jashtë gjuhëve ku një OE duhet të paraqes një ofert, dhe që janë në kundershtim me nein 13 te LPP-së.

Schweißverfahren: *Welding process:*	Werkstoffgruppe: *Material group(s):*	Untergruppe subgroup
Heizelementstumpfschweißen	3 PE	3.4
Heizelementstumpfschweißen	3 PE	3.5
Heizwendelschweißen	3 PE	3.6
--	--	--

Detal nga dokumenti I dorëzuar nga OE, jashte nenit 13 të LPP-së. Pra, deshmia është në kundërshtim me nein 13 të LPP-së. Pra, nuk kuptohet se per cfare lloji te salldimit janë testuar.

Kërkojm që shqyrtimi të jetë i barabart për palët, sipas nenit 7 të LPP-së, pa ndonjë anim miqësor apo interesi tjetër dhe aktivitti i prokurimit të rivlersohet në mënyr të barabart dhe pa diskriminim dhe ankesa jonë të aprovohet si e bazuar.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Demet duhet të përcaktohen nga ndonjë pal ndergjygjese e tret , ekspert financial ligjor.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*